




**Republika e Kosovës**  
Republika e Kosovës – Republic of Kosova  
Qeveria e Kosovës – Vlada Kosova – Government of Kosova



**QENDRA E STUDENTËVE  
E UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS  
PRISHTINË**

**STUDENTS' CENTER OF  
UNIVERSITY OF PRISHTINA  
PRISHTINA**

**STUDENTSKI CENTAR  
UNIVERSITETA PRISHTINE  
PRISHTINA**



Rruga "Agim Ramadani" p.n., 10 000 Prishtinë, Kosovë

Në bazë të nenit 9 dhe 13, të Statutit të Qendrës së Studentëve të Universitetit të Prishtinës në Prishtinë të datës 05.05.2017, Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve të Prishtinës në Prishtinë, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR DEPOZITAT PËR STREHIMIN E STUDENTËVE NË QENDRËN E STUDENTËVE NË PRISHTINË**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Me këtë Rregullore përcaktohet lartësia e depozitave, mënyra e pagesës dhe kriteret për shfrytëzimin e mjeteve të arkëtuara në emër të depozitave.

### **Neni 2**

Studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës së studentëve me rastin e vendosjes për banim në konvikte, bëjnë depozitim të një shume të caktuar të të hollave. Shuma e mjeteve që duhet të depozitohet, caktohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve në bashkëpunim me MASHT-in.

### **Neni 3**

Nëse studentët shfrytëzues të resurseve të Qendrës iu përmbahen me përpikëri të drejtave, përgjegjësive dhe detyrimeve që parashihen me aktet normative të miratuara nga Qendra dhe nëse gjatë kohës së banimit nuk shkaktojnë dëme materiale atëherë mjetet e depozituara në tërësi i'u kthehen atyre, me përjashtim të shumës prej 2,00 euro (ndalesa për amortizim). Rruga e rimbursimit të mjeteve është e njëjtë me ecurinë e arkëtimit-pagesës. Paga dhe rimbursimi bëhet në cilëndo nga Bankat afariste në Kosovë.

### **Neni 4**

Studentët të cilët për shkaqe të ndryshme dëshirojnë ta ndërprejnë shfrytëzimin e resurseve të Qendrës janë të obliguar që të veprojnë konform nenit 28 të Rregullores mbi vendosjen e studentëve, sipas të cilit janë të obliguar që 30 ditë më parë ta paralajmërojnë lëshimin e konviktit. Me rastin e lëshimit të konviktit duhet t'i dorëzojnë të gjitha pajisjet, sipas reversit komisionit përkatës në vendin e ngjarjes. Komisioni në praninë e studentit duhet të bëjë vlerësimin e dëmtimit eventual të inventarit apo pajisjeve tjera nga ana e studentit. Komisioni do të vendos për lirimin e tij ose do ta caktojë shumën që studentit duhet ta kompensojë.



### Neni 5

Varësisht nga vlerësimi i dëmit të shkaktuar, ndalesa e mjeteve të depozituara mund të bëhet plotësisht ose pjesërisht. Lartësia e ndalesës precizohet me çmimore të veçantë. Çmimorën e detajuar për secilin pozicion e cakton Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve para fillimit të sezonës së banimit në konvikt. Çmimorja nuk mund të ndryshohet brenda një sezoni të banimit.

### Neni 6

Ndalesa e depozitave bëhet në përputhje me nenin 23 dhe 24 të Rregullores mbi të drejtat, obligimet dhe kufizimet e studentëve-shfrytëzues të resurseve të Qendrës, si vijon:

- Nëse studenti nuk e paguan banimin dhe nuk e ka paralajmëruar me kohë lirim të vendit sipas Rregullores.
- Ndërrimi i dhomës, katit apo i konviktit pa pëlqimin e personit të autorizuar.
- Dhënia e shtratit për shfrytëzim personit të tretë.
- Mbajtja e padeklaruar e personave tjerë në dhomë (ilegalëve).
- Studentët e liruar nga pagesat për strehim (100%) ose strehim dhe ushqim (100%) nuk u kthehet depozitat në fund të vitit si rezultat i marrjes së shërbimeve pa pagesë gjatë vitit.
- Përdorimi i furnelave (reshove), hekurit për ngrohje e ujit, nxehëseve elektrike apo kondicionerëve.
- Përdorimi i mjeteve radiodifuzive (Radio, TV, etj.) si dhe instrumenteve tjera muzikore me të cilat mund të prodhohet muzikë zhurmuese.
- Meremetimi, ndërrimi i vendit të ndërprerësve të rrymës, i prizave, dritave apo zhvendosja e intervalit tjetër në dhomë apo hapësirat e përbashkëta.
- Vendosja e posterëve, fotografive, tapicerive apo gozhdave nëpër muret e dhomës pa leje paraprake,
- Vendosja e shpalljeve, njoftimeve, afisheve apo publikimeve tjera pa sigurimin e lejes paraprake nga personat e autorizuar në konvikt, gjegjësisht në Qendrën e Studentëve.
- Zierja e gjellërave nëpër dhoma.
- Mbajtja e ushqimit të freskët apo konservuar.
- Mbajtja në dritare i kavanozave me pemë e perime të konservuara apo shisheve me lëngje të ndryshme.
- Mbajtja dhe ruajtja e ushqimit të thatë në dhomë, etj.

Pagesa e depozitave mund të hiqet nga Drejtori i Përgjithshëm i QS-së, në muajt e fundit të vitit akademik me qëllim të rritjes së numrit të pagesave nga vendosja e banuesëve të rinj.

### Neni 7

Vlerësimi i dëmit përkitazi me propozimin e ndalesës nga mjetet e depozituara bëhet nga udhëheqësi i konviktit dhe stafi i tij. Përbërjen e komisionit dhe numrin e anëtarëve e cakton udhëheqësi i konviktit me vendim të veçantë. Komisioni është i obliguar të përpunojë mirë Rregulloren përkatëse dhe aktet tjera normative në nivel të Qendrës. Komisioni për punën ose mos punën e tij i përgjigjet drejtorit të strehimit.

### Neni 8

Në qoftë se dëmi i vlerësuar është më i madh se vlera e depozituar, kompensimi do të bëhet nga mjetet shtesë të shkaktarit të dëmit. Vlera e dëmit të shkaktuar, respektivisht çmimet janë të përcaktuara edhe në revers.





### **Neni 9**

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje bëhet sipas procedurës së njëjtë me të cilën edhe është miratuar.

### **Neni 10**

#### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Depozitat për strehimin e studentëve në Qendrën e Studentëve në Prishtinë, nr.113 të datës 29.03.2017.


### **Neni 11**

#### **Hyrja ne fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Qendrës së Studentëve.

**Prishtinë**

*29.12.2022*



**Drejtori i Përgjithshëm  
Fatmir Sfishta**

*[Handwritten signature]*

